



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr : 04-353/01-34375

Data: 03. 06. 2025

Prizren

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSIROR KK – PRIZREN, me kërkesën e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik - investitor Komuna e Prizrenit, me të cilën pala ka kërkuar leje për: „Ndërtimi i infrastrukturës (rrugë, ambienti) turizëm malor dhe rural-Vlashnje, Muradem”. Në bazë të e në bazë të nenit 3 paragrafit 1, pika 1.27 të Ligjit për Planifikimit Hapësinor me Nr.04/L-174 të Dt. 31. 07. 2013, nenit 3.1.1, 1.2, 1.4, 1.17, 1.24, e në lidhje me nenin 4, 1.2 si dhe nenit 5,1.1 e lidhur me nenin 14.1.4, të Ligjit për ndërtim nr. 04/L-110, si dhe konform nenit 40 alinea 4 dhe nenit 41 alinea 1, dhe të nenit 45 e lidhur me nenin 51 dhe konform Vendimit të HZK për periudhën 2022-2030 Nr.001-011-48192 të dt 31. 03. 2022 dhe në harmoni me dispozitat 3. alenia 1 pika 1.1, 1.3, 1.5 dhe 1.5, dhe të nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 82.83 e në lidhje me nenin 84.85. LPA-së nr. 02/L-28, merr këtë:

AKTVENDIM

I LEJOHET Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik - investitor Komuna e Prizrenit, me të cilën pala ka kërkuar leje për: „Ndërtimi i infrastrukturës (rrugë, ambienti) turizëm malor dhe rural-Vlashnje, Muradem”.

- I. Dokumentacioni teknik e mban titullin e tipit të veçantë -Projekti i punuar nga Byroja projektuese „STUDIO HAPSIRA” SH.P.K.– Prishtinë.
- II. Datën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin komunal në afat prej 8 ditësh.
- III. Hunjëzimi të bëhet simpas dokumentacioni teknik..
- IV. Investitori është i obliguar që punimet të kryen në bazë të dokumentacioni teknik-projektin, e në pajtim me normat ndërtimore dhe rregullave të përkohshme teknike për kësi llojë punime.
- V. Investitori është i obliguar që punimet rreth infrastruktures të kryen sipas Aktvendimit të dhëna, kurse vend punimi natën të ndriqohet me dritë ashtu që të mundësohet qarkullimi i lirë i automjeteve dhe të këmbësorëve, kurse materialet të tjera duhet të menjanohen nga rruga ku janë kryer punimet.
- VI. Pas kryerjes së punimeve Investitori është i obliguar që vendin e gropuar menjëherë të bjerë në gjendje të mëparshme.
- VII. Pas përfundimit të ndërtimit investitori duhet të parashtrorë kërkesën për pranimin teknik dhe marrjen e lejes për shfrytëzim.
- VIII. Në qoftëse punimet në infrastrukture nuk mund të kryen në afatin e lejuar, Investitori është i obliguar që të kërkoj nga ky organ leje për vazhdimin e afatit të punimeve.

IX. Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12 (dymbdhjetë) muajsh,duke llogaritur nga dita e marrjes së të njëjtës.

P.S. DTZHE gjatë implementimit të projektit merr përsipër për problemet eventuale që mund të dalin lidhur me çështje pronësore juridike duke bërë zgjidhje sa më të mirë të mundshme.

A r s y e t i m

Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik - investitor Komuna e Prizrenit, është drejtuar këtij organi për marrjen e lejes për:

„Ndërtimi i infrastrukturës (rrugë, ambienti) turizëm malor dhe rural-Vlashnje, Muradem”.

Duke shqyrtuar kërkesën e Investitorit si dhe dokumentacionit teknik dhe të shtojcave tjera të prezentuara s’bashku me kërkesë vërtetohet se:

Në procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.


Në kuptim të dispozitave të lartë theksuara është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes për :

„Ndërtimi i infrastrukturës (rrugë, ambienti) turizëm malor dhe rural-Vlashnje, Muradem”.


Nga se u tha më lartë uvendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës MMPHI-së-Prishtinë.

Bashkëpunëtor profesional:


Ylber Gashi, inxh. dip. ark.

DREJTORI:




Pranverim Berisha, jur. dip.